



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 05.02.2026
Numër Protokolli: 677/2026

A.nr.56/2026

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.56/2026, të datës 19.01.2026, të parashtruar nga ankuesi, B.S, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.56/2026, të datës 19.12.2026, të parashtruar nga ankuesi, B.S.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, B.S, (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesi), më datë 19.12.2026, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar po të njëjtën datë nën shenjë A.nr.56/2026, kundër Vendimit A.nr.1499/2025, të datës 19.12.2025, të Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes së cilit është anuluar procedura e rekrutimit me numër reference RN00017335, pozita e punës Inspektor i Marrëdhënie të Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, Inspektorati Qendror i Punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në *tekstin e mëtejme referuar*: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se - Inspektorati i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017335, Grupi Ligjor, pozita e punës Inspektor për Marrëdhënies të Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës numri i kërkuar gjashtë (6), klasa profesional 1, të gjithë ma afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Tutje, sipas provave materiale të çështjes del së në konkursin përkatës të punësim ka aplikuar edhe ankuesi, i cili sipas Njoftimit, të datës 11.07.2026, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës, njëjti është shpallur si kandidat fitues për pozitën përkatëse me 71.8 pikë, duke u renditur i pari në listën fituese.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1499/2025, të datës 19.12.2025, të parashtruar nga kandidatja A.Z me Vendimin A.nr.1499/2025, të datës 19.12.2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit, duke anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00017335, për Grupin Ligjor, gjegjësisht për pozitën e punës Inspektor për Marrëdhënie të Punës, në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit A.nr.1499/2025, të datës 19.12.2025, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli Nr.2611, të datës 31.12.2025 nga i cili njoftim rezulton se procedura e rekrutimit me reference RN00017335 është anuluar.

Pas publikimit të njoftimit me numër protokolli Nr.2611, të datës 31.12.2025 ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Vendimin me numër A.nr.1499/2025, të datës 19.12.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Njoftimin me numër protokolli Nr.2611, të datës 31.12.2025, të Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës.

Andaj, nisur nga gjendja e fakteve si me sipër, Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 104 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***, vlerëson së objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, mbi faktin së Këshilli me vendim përfundimtar ka vendosur lidhur me ligjshmërinë e procedurës së pranimit më numër reference RN00017335, rrjedhimisht duke e anuluar të njëjtën si të paligjshme.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.56/2026

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, B.S;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së